**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER GENTIANA SH. DORËZI**
**ADRESA NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.24**
**TEL: 682078604**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 813** **Nr. koleksioni: 154**

**Tirane më 10/07/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A202405260001 5696381

*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë

Taksa e pullës 700 leke e likujduar në kopjen e arkivës së noterit

A2024052600015696381

**NR. 813 REP NR . 154 KOL**

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

*TË SHOQËRISË* ""KONEX" sh.p.k"

Sot, më datë 10 korrik 2024, para meje Notere GENTIANA SH. DORËZI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.24, u paraqiten personalisht:

- **SHITESI: zj. ANASTASI PETRAJ**, Atësia Stavri, amësia Polikseni, shtetase Shqiptare, lindur në Selenice, Vlorë dhe banuese në TIRANË, me adresë: Rr."Rrapo Hekali"; Nd. 17; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 28/10/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036795501 dhe nr.personal I36028063W(Pala shitese ne momentin e fitimit te kuotes dhe sot eshte me status civil "beqar", vertetuar me Çertifikata personale 10.07.2024 Si rrjedhim, kuota e kapitalit nuk i perket regjistrit pasuror martesor ne bashkesi (neni 77/a i Kodit te Familjes), ajo eshte pasuri vetjake; ketu e me më poshtë, për efekte të kësaj kontrate referuar si **Shitesi).**

- **BLERESI : Z. YLLI CENAJ**, atësia Vizhdan, amësia Myzejen, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë M.Grameno; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 09/03/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034151903 dhe nr. personal I60309062L, vertetuar me Çertifikate personale marre nga e-Albania me 10.07.2024 (neni 77/a i Kodit te familjes); ketu e me më poshtë, për efekte të kësaj kontrate referuar **si Bleresi).**

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "KONEX" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Anastasi Petraj

Ylli Cenaj

A202405260001569638I

BAZA LIGJORE

- Kushtetuta e Shqiperise neni 8 dhe 41
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**MEQENESE:**

A. Shitësi zoteron 1,00 kuote, qe perfaqeson 50.00 % te kuotave te kapitalit te Shoqerise "KONEX" sh.p.k, një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me 17.02.2017, me NUIS - L71417022J, me seli ne Tirane; Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.k 8830, Njesia Bashkiake nr 9, Tirane.

B. Kapitali i shoqërisë është 100,000 lekë (njeqindmije lekë), ne pronesi te ortakeve

z.Erjon Kajo: 1 kuote Pjesëmarrja në përqindje (%) 50,00 dhe

**Anastasi Petraj 1 kuote , Pjesëmarrja në përqindje (%) 50,00**

**C Me anë të kësaj kontrate Shitësi,** Anastasi Petraj **qe** zoteron 1,00 kuote, qe perfaqeson 50.00 % te kuotave te kapitalit **i transferon Blerësit, ortakut te ri me anë të shitblerjes, 1 kuote,** qe perfaqeson 50.00 % (pesedhjete perqind) të kapitalit të Shoqërisë "KONEX " sh.p.k.

D. Blerësi **YLLI CENAJ**, deshiron te bleje 1 kuote, qe perfaqeson 50.00 % të kapitalit te Shoqërisë "KONEX" sh.p.k.;

E. Në përputhje me Nenet e Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008 me ndryshimet perkatese, Ortaket Erjon Kajo dhe Anastasi Petraj kane marre vendimin perkates, per transferimin tek Bleresi te kuotes se me siper.

Palet bien dakord per nenshkrimin e kesaj kontrate per shitjen e kuotave sipas kushteve te meposhtme

**NENI 1 Perkufizime**

Perveç shprehjeve te tjera te perkufizuara ndryshe ne kete Kontrate, per qellimet e saj, fjalet dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimin e meposhtem:

| | |
|---|---|
| *"Kontrate"* | do te thote kjo Kontrate per Blerje Kuotash – duke perfshire si pjese perberese te saj, deklaratat paraprake te mesiperme; |

Anastasi Petraj

Ylli Cenaj

A2024052600015696381

| | |
|---|---|
| *"Shoqeria"* | Shoqeria "**KONEX" Sh.p.k.,** eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, me NUIS- L71417022J, me seli ne adresen: ; Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.k 8830, Njesia Bashkiake nr 9, Tirane. |
| *"Barre"* | do te thote cdo hipoteke, detyrim, peng, garanci, e drejte zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta per t'u ofruar i pari ne blerje, e drejta ose interesi i nje pale te trete, barre ose interesa siguruese te cdo lloji, ose cdo lloj tjeter marreveshjeje preferenciale (duke perfshire por pa u kufizuar ne transferimin e nje titulli ose te nje marreveshje kontrolluese) me efekte te ngjashme; |
| "Pala" ose "Palet" | do te thote Bleresi ose Shitesi ose te dy se bashku, sic e kerkon permbajtja; |
| *"Cmimi i Blerjes"* | do te thote cmimi qe Bleresi i paguan Shitesit per blerjen e Kuotave, sic percaktohet ne Nenin 3 te kesaj Kontrate; |
| "Kuota ne Shitje" | do te thote e barabarta me 50.00 % (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise. |

**NENI 2 Objekti i Kontrates**

2.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate (10 korrik 2024"Data e Nenshkrimit"), Shitesi shet tek Bleresi dhe Bleresi blen nga Shitesi 1 kuote, qe perfaqeson 50.00 % te kuotave te shoqerise ne shitje te lira nga cdo Barre.

2.2 Kuota ne Shitje do te transferohen nga pronesia e Shitesit ne pronesi te Bleresit dhe pala Blerese do te behet zoteruesi ligjor i kuotes ne shitje menjehere pas regjistrimit te kesaj kontrate prane QKB-se.

**NENI 3 Çmimi i Shitjes**

3.1 Çmimi i shitjes i pagueshëm nga blerësi për 1 kuote, qe perfaqeson 50.00 % që zotëron shitësi, **ANASTASI PETRAJ**, në kapitalin e shoqërisë, eshte 50.000 lekë (pesedhjetemije leke), shume totale e cila do të kryhet me pagesë të plotë ne llogarine bankare te shitesit

Pagesa do të kryhet nga llogaria bankare e Shitesit në llogarinë bankare te e zj. **ANASTASI PETRAJ** brenda 3 (tre) diteve pune bankare nga e nesermja e nenshkrimit te kontrates. Mungesa e transfertes bankare e ben kete kontrate "nul" dhe pa efekte ligjore .

3.2 Shitësi dhe Blerësi janë në dijeni se sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht ligjit Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", BLERËSI dhe Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë

mban detyrimin që brenda afatit ligjor të regjistroje në Qendrës Kombëtare të Biznesit një njësi origjinale të kësaj kontrate Shitje dhe kryer veprimet respektive për rregjistrim ndryshim pronësisë të pjersëmarrjes dhe te pronarit perfitues .

## NENI 4 Deklarimet dhe Garancite e Shitesave

4.1 Shitesi deklaron dhe garanton ne lidhje me transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijojne.

4.1.1 Autorizimi – Te gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe/ose aktet e Shoqerise qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht. Kjo Kontrate eshte nenshkruar dhe dorezuar rregullisht nga Shitesi dhe perben nje detyrim te vlefshem dhe ekzekutiv per Shitesin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.

4.1.2 Nenshkrimi – Nenshkrimi i kesaj Kontrate nuk kerkon asnje depozitim, miratim, autorizim te cfaredolloji nga ndonje autoritet shteteror ose pale e trete.

4.1.3 Pronesia – Shitesi eshte pronar i ligjshem i Kuotes ne shitje. Kuota eshte blere me akt notarial sipas kontrates se shitjes nr.252 rep., nr.47 kol.,, date 09.02.2024 me ane te se ciles sipas ligjit ne fuqi eshte bere ne QKB transferimi i 50 % te kuotave te shoqerise nga ortaku Erjon Kajo ne favor te Anastasi Petraj. .

4.1.4 Kuotat - Kuotat jane te lira dhe te cliruara nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Kuotat ne perputhje me afatet e kasaj Kontrate. Nuk ka asnje kontrate, marreveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Kuotat ose ndonje numer Kuotash te autorizuara por te paemetuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat. Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe parashikon dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhenien e se drejtes nje personi, te drejten e parablerjes apo te kembimit, ne lidhje me Kuotat objekt te kesaj kontrate.

4.1.5 Mbi blerësin nuk rëndon asnjë detyrim i lindur mbi kuotat që zotërojne shitësi deri ne momentin e kalimit të pronësisë të saj.

4.1.6 Shitesi heq dore nga cdo pretendim ne lidhje me fitimet apo rezervat e akumuluara qe perfiton ne formen e dividentit ose cdo perfitim tjeter te krijuar nga blerja ekuotes se tij deri ne daten e transferimit te kuotave. Te gjitha te drejtat dhe detyrimet i transferohen bleresit.

## Neni 5 Ligji i zbatueshem dhe juridiksioni kompetent

Anastasi Petraj

Ylli Canaj

A202405260001569638l

5.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligji Shqiptar.

5.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të këesaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.3 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane

**Neni 6 Te ndryshme**

6.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, dhe nenshkruhet nga ose ne emer te seciles Pale

6.2 Ne rast se një dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjeter, nuk do te preket nga nje fakt i tille.

6.3 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.

6.4 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen shqipe

6.5 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe/ose te transferoje te drejtat dhe/ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjeter.

6.6. Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila Pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe shtojcave te saj.

**Neni 7 Pronësia e kuotave**

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pasqyrimit të ndryshimeve përkatëse në QKB, z **YLLI CENAJ**, behet pronare e 1 nje kuote, qe perfaqeson 50,00 % te kuotave te kaliptalit te Shoqerise "KONEX"sh.p.k., me vlere 50.000 leke (pesedhjetemije).

Me regjistrimin e kontrates se shitjes se kuotave prane QKB, Shoqeria "KONEX" sh.p.k. do te kete 2 (dy) ortake:

- z.Erjon Kajo, zoterues i 1 kuote, qe perfaqeson 50,00 % kapitalin e shoqerise, me vlere te pergjithshme 50.000 leke.dhe

Anastas Petrej    Ylli Cenaj

A202405260001569638l

**- z YLLI CENAJ, zoteruese e 1 kuote, qe perfaqeson 50,00 % kapitalin e shoqerise, me vlere te pergjithshme 50.000 leke**

Shitësi dhe blerësi përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit ne QKR . Bazuar ne nenin 22 te Ligjit Nr. 9723 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", palet njohin afati ligjor per regjistrimin ekontrates se shitjes se kuotave si dhe faktin Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e tyre, brenda afateve ligjore, përben kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, Neni 74, Ligji 9723 "Per QKR.

**Neni 8 ANEKSET E KONTRATËS**

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;

- Vendimi i Asamblese se Ortakeve te "KONEX" sh.p.k., datë 10.07.2024

. - Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "KONEX" Sh.p.k., datë 10.07.2024.

- -Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë date 10.07.2024N
Numri i Dokumentit: D-400-600-270 Numri i Rezultatit te kerkimit: D-20240710103504181
Data e Rezultatit te Kerkimit: 10.07.2024, Ora e Rezultatit te Kerkimit: 10:35:04

- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

**Neni 9 Dispozitat Përfundimtare**

9.1 Kontrata e Shitjes të kuotave ne modelin ligjor te sjelle nga bleresi u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, I kane kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

9.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

9.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

| | |
|---|---|
| **SHITES** | **BLERES** |
| Anastasi Petraj | Ylli Cenaj |

Noter GENTIANA SH. DORËZI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Bashkia** Tiranë

**Njësia administrative** Farkë

**Zyra e Gjendjes Civile** 391

Datë: 10.07.2024

# CERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Përbërës të Gjendjes Civile | |
|---|---|
| Emri | Anastasi |
| Mbiemri | PETRAJ |
| Numri Personal | I36028063W |
| Emri i Babait | Stavri |
| Emri i Nënës | Polikseni |
| Datëlindja | 28-10-1983 (tetëdhjetë e tre) |
| Vendlindja | Selenice, Vlorë |
| Vendbanimi | RRAPO HEKALI; Nd. 17; H. 1;<br>FARKË; SELITË; 1044; TIRANË |
| Gjinia | Femer |
| Gjendja Civile | Beqar/e |
| Shtetësia | Shqiptare |

Kjo certifikatë lëshohet për Dokument

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2024/07/10 11:27:09 +02'00'
I36028063W20240710112701 96P001

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Bashkia** Tiranë

**Njësia administrative** Nr. 2

**Zyra e Gjendjes Civile** 374

Datë: 10.07.2024

# CERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| **Përbërës të Gjendjes Civile** | |
|---|---|
| Emri | Ylli |
| Mbiemri | CENAJ |
| Numri Personal | I60309062L |
| Emri i Babait | Vizhdan |
| Emri i Nënës | Myzejen |
| Datëlindja | 09-03-1986 (tetëdhjetë e gjashtë) |
| Vendlindja | Tiranë |
| Vendbanimi | M.Grameno; Nd. .;<br>Tirane; Njesia bashkiake nr. 2; 0000; Tiranë |
| Gjinia | Mashkull |
| Gjendja Civile | Beqar/e |
| Shtetësia | Shqiptare |

Kjo certifikatë lëshohet për Dokument

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2024/07/10 11:31:19 +02'00'
I60309062L20240710113107 47P001

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L71417022J |
| 2. Data e Regjistrimit | 17/02/2017 |
| 3. Emri i Subjektit | KONEX |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 16/02/2017 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 16/02/2017 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.k 8830, Njesia Bashkiake nr 9, Tirane. |
| 8. Kapitali | 100.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Tregtim me shumice dhe pakice import-eksport, i pajisjeve dhe materialeve elektronike, elektrike dhe elektromjeksore duke perfshire instalim, perdorim, sherbim, servis,konsulence teknike. Tregtim me shumice dhe pakice import eksport i artikujve te ndryshem industrial, makineri e pajisje te industrive te lehta, te renda, makineri e pajisje te teknologjise se larte, duke perfshire instalim, perdorim,sherbim, servis, konsulence teknike. Tregtim me shumice dhe pakice import-eksport i pajisjeve per prodhimin e energjise se paster dhe te rinovueshme duke perfshire instalim, perdorim, sherbim, servis, konsulence teknike. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport i produkteve dhe nenprodukteve bujqesore dhe blegtorale, duke perfshire perpunim, ambalazhim, konsulence. Tregtim me shumicedhe pakice, import-eksport i produkteve IT duke perfshirezhvillim, instalim, perdorim, sherbim, servis, konsulenceteknike. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport iprodukteve promocionale, marketingu, artikujve kancelarik,libra e shtypshkrime te ndryshme. Tregtim me |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| | shumice dhepakice, import-eksport i produkteve dhe paisjeve temobilerise, lende e pare, artikuj gjysem te gatshem, artikuj te perfunduar dhe aksesore. Shit-blerje apo dhenie me qera te pasurive te paluajtshme. Import-eksport, instalim dhe mirembajtje te gjeneratoreve me rreze X | |
| 10. Administratori/ët | Erjon Kajo | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 28/06/2022 | Deri: 28/06/2027 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | AnastasiPetraj | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Ortakët | ErjonKajo | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 13.4 Komente (nëse ka) | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: KONEX<br>E-Mail: e.kajo@konex.al<br>Telefon: 0682000048 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 10/07/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/07/10 11:35:16 +02:00
L71417022J2024071011350853
2006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240710103504181 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 10.07.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 10:35:04 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Fizik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-600-270 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**ANASTASI STAVRI PETRAJ**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE
R.B.S.
TIRANE ALBANIA

Ada Qoqja

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240710103504181 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 10.07.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 10:35:04 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Juridik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-600-270 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**KONEX SH.P.K.**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE ALBANIA

**SUBJEKTI KERKUES:**

Emertimi
GENTIANA SHYQRI DOREZI P.F.

Ada Qoqja

**TE DHENAT E PERDORUESIT:**

Emri dhe Mbiemri
ADA QOQJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GENTIANA SH. DORËZI
ADRESA NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.24
TEL: 682078604

# VËRTETIM NËNSHKRIMI

(VËRTETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)

**Nr. repertori: 812**

**Tirane më 10/07/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

V20240526000673658887

KONEX" sh.p.k,

**VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

**TË SHOQËRISË "KONEX" sh.p.k," sh.p.k.**

Nr. 4 Datë 10/07/2024

Sot më datë 10/07/2024, në selinë e Shoqërisë "KONEX" sh.p.k, një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me 17.02.2017, me NUIS - L71417022J, me seli ne Tirane; Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.k 8830, Njesia Bashkiake nr 9, Tirane u mblodh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë me pjesëmarrjen e ortakëve:

- **Erjon Kajo**, atësia Ilir, amësia Efrosina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë: Blv."Gjergj Fishta"; Nd. 42; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 26/01/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 034889974 dhe nr. personal I70126075H.
- **ANASTASI PETRAJ**, Atësia Stavri, amësia Polikseni, shtetase Shqiptare, lindur në Selenice, Vlorë dhe banuese në TIRANË, me adresë: Rr."Rrapo Hekali"; Nd. 17; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 28/10/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 036795501 dhe nr. personal I36028063Ë

Rendi I ditës transferimi me shitje I kuotes se **ANASTASI PETRAJ**, tek bleresi I ardhshem **YLLI CENAJ**,

Ortakët prezent përfaqësojnë tërësisht pjesët e kapitalit themeltar të Shoqërisë.

**Z.Erjon Kajo, zoterues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 50.000 lekë, të cilat përfaqeson 50,00% te kapitalit te shoqerise,**

**Zj. Anastasi Petraj, zotërues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 50.000 lekë, te cilat përfaqëson 50,00% te kapitalit te shoqerise**

Asambleja, e thirrur rregullisht dhe sipas statutit e ligjit, është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur me rendin e ditës, si më poshtë vijon:

1. Shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga ortaku **ANASTASI PETRAJ**, për lejimin e shitjes se kuotave të kapitalit të shoqërisë .

Pas diskutimit të cështjes Asambleja e Ortakëve, duke marrë parasysh që ortaku ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes së kuotave te ortakëve të tjerë, me unanimitet të plotë

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga ortaku **ANASTASI PETRAJ**. për lejimin e shitjes së kuotës që përfaqëson të gjithe pjesën që ajo zotëron. Z.**YLLI CENAJ**, atësia Vizhdan, amësia Myzejen, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë M.Grameno; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 09/03/1986, gjendja civile "beqar", me Leternjoftim ID nr. 034151903 dhe nr. personal I60309062L, .

2. Pas neshkrimit te kontrates sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht ligjit 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", BLERËSI dhe Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mban detyrimin që brenda afatit ligjor të regjistroje në Qendrës Kombëtare të Biznesit një njësi origjinale të kësaj kontrate Shitje dhe kryer veprimet respektive për rregjistrim ndryshim pronësisë të pjersëmarrjes dhe te pronarit perfitues .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Për sa u diskutua dhe u vendos më sipër, ky Vendim nënshkruhet pa verejtje nga Ortakët e Shoqërisë, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Për Asamblenë e Ortakëve të Shoqërisë "**KONEX**" sh.p.k.

**ORTAKËT**

Anastasi Petraj Erjon Hajo

konex MEDICAL SOLUTIONS

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER GENTIANA SH. DORËZI**

PULLE TARIFE
200 LEKË
R.SHQIPËRISË

V2024052600067365887

| |
|---|
| **DATE 10/07/2024** |
| **NR REP 812** |

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 10 korrik 2024, para meje Notere GENTIANA SH. DORËZI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.24, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES**: Ortaket e Shoqërise KONEX, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L71417022J, me seli në me adresë Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.K 8830, Njesia Bashkiake Nr 9, Tirane., përfaqësuar nga

**z. Erjon Kajo,** atësia Ilir, amësia Efrosina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Gjergj Fishta; Nd. 42; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 26/01/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034889974 dhe nr. personal I70126075H.

**zj.Anastasi Petraj,** atësia Stavri, amësia Polikseni, shtetase Shqiptare, lindur në Selenice, Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Rrapo Hekali 03910112; Nd. 17; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 28/10/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036795501 dhe nr. personal I36028063W

te cilet me DEKLARUAN SE KANE NESHKRUAR ME VULLNET TE PLOTE VENDIMIN E DATES 10.7.2024 e Asamblese se Ortakeve te shoqërise KONEX sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L71417022J,bashkëlidhur. Unë NOTERI, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

GENTIANA SH. DORËZI

# Njoftim Debitimi / Debit Advice

**Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX**

Raiffeisen BANK

Dega / Branch 024

Data / Date 10/07/2024

| | |
|---|---|
| Midas Reference / Midas Reference Number | P240710AJQ6OP08 |
| Luka Reference / Luka Reference Number | 20240710Vilma.Tola02450837 |
| Klienti Urdherues / Ordering Customer | YLLI VIZHDAN CENAJ (Mar 9 1986 ) |
| Adresa / Address | RR MIHAL GRAMENO PLL58/2 |
| Numri i llogarise / Account Number | 0021392038 |
| IBAN | AL76202112880000000021392038 |
| Shuma e urdheruar | 50,000.00 |
| Monedha | ALL |
| Kursi i kembimit | 103.10000000 |
| Detajet e pageses / Details of Payment | KALIM SIPAS KONT<br>REP 813 KOL 154<br>DT 10.07.2024<br>SHITJE KUOTA KAPITAL |
| Komisione / Commissions | 800.00 |
| Komisione Swift / Swift Commissions | 0.0000 |
| Komisione Priority / Priority Commissions | 0.0000 |
| Komisione Our / Our Commissions | 0.0000 |
| Komisione Total / Total Commissions | 800.0000 |
| Klienti Perfitues / Beneficiary Customer | ANASTASI PETRAJ |
| Adresa / Address | TIRANE<br>.<br>. |
| Banka e perfituesit / Beneficiary Bank | Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a |
| Banka Korrespondente / Correspondent Bank | EUR10 |
| Numri i llogarise | AL49208113140000A4390135101 |
| IBAN | |
| Date Valuta / Value Date | 11/07/2024 |

***Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!***

*Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato.Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.*

# Njoftim Kreditimi / Credit Advice

**Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX**

Raiffeisen BANK

Dega / Branch 024

Data / Date 10/07/2024

| | |
|---|---|
| Midas Reference / Midas Refence Number | P240710AJQ6OP08 |
| Numri i references / Reference Number | 20240710Vilma.Tola02450837 |
| Klienti Perfitues / Beneficiary Customer | ANASTASI PETRAJ |
| Adresa / Address | TIRANE<br>.<br>. |
| Banka e Perfituesit / Beneficiary's Bank | Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a |
| Banka Korrespondente / Correspondent Bank | EUR10 |
| Numri i llogarise / Account Number | AL492081131400000A4390135101 |
| IBAN | |
| Shuma e perfituar | 484.97 |
| Monedha | EUR |
| Kursi i kembimit | 103.10000000 |
| Detajet e pageses / Details of Payment | KALIM SIPAS KONT<br>REP 813 KOL 154<br>DT 10.07.2024<br>SHITJE KUOTA KAPITAL |
| Komisione / Commissions | 800.00 |
| Komisione Swifti / Swift Commisions | 0.0000 |
| Klienti Urdherues / Ordering Customer | YLLI VIZHDAN CENAJ (Mar 9 1986 ) |
| Adresa / Address | RR MIHAL GRAMENO PLL58/2 |
| Numri i llogarise | 0021392038 |
| IBAN | AL76202112880000000021392038 |
| Date Valuta / Value Date | 11/07/2024 |

***Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!***

*Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato.Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.*